



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit




Raport Statistikor **Shkurt 2018 – Prill 2020**

Komisioni i Pavarur i Kualikimit nga data 8 shkurt 2018 deri në datën 30 prill 2020 ka dhënë **246** vendime.


- **101** vendime për konfirmimin në detyrë të 44 gjyqtarëve, 48 prokurorëve dhe 9 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **90** vendime për shkarkimin nga detyra të 56 gjyqtarëve, 32 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë/kandidatë për magjistratë;
- **30** vendime për ndërprerjen e procesit të 21 gjyqtarëve, 7 prokurorëve dhe 2 ish-ndihmës ligjor;
- **8** vendime për pushimin e procesit të 3 gjyqtarëve, 1 prokurori dhe 4 ndihmësve ligjorë;
- **16** vendime për përfundimin e procesit pa një vendim përfundimtar, për kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, 10 gjyqtarëve dhe 5 prokurorëve;
- **1** vendim për pezullim nga detyra për një periudhë 1-vjeçare.

Këto vendime pasqyrohen në grafikët e mëposhtëm.

Grafik 1: Vendimet e KPK-së, 8 shkurt 2018 – 30 prill 2020.




Grafik 2: Konfirmimet në detyrë në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit.




Komisioni i
Pavarur i
Kualifikimit


Grafik 3: Shkarkimet nga detyra në bazë të funksionit të subjektit të rivlerësimit.




Grafik 4: Ndërprerjet e procesit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.



Grafik 5: Pushimi i procesit sipas nenit 56 të ligjit nr. 84/2016.




Grafik 6: Përfundimet e procesit pa një vendim përfundimtar.




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

Grafik 7: Pezullimet nga detyra.




Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **231** vendime me unanimitet, ku të gjithë anëtarët e trupit gjykues kanë votuar në mënyrë të njëjtë dhe **15** vendime me shumicë votash.

Grafik 8: Vendime me unanimitet dhe shumicë votash.



Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **31** vendime bazuar në një kriter, **13** vendime bazuar në dy kritere dhe **149** bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit.

Grafik 9: Numri i vendimeve sipas kritereve të rivlerësimit.



Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pas ankimimit të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, deri më 30 prill 2020, ka marrë 51 vendime nga të cilat:

a) **33** lënie në fuqi të vendimeve të Komisionit;


b) **15** ndryshim vendimi, prej të cilave;

2 vendime të ndryshuara pjesërisht (subjektet M. Fana, A. Llalla) dhe 13 vendime të ndryshuara plotësisht (për subjektet B. Dedja, A. Sevdari, A. Faqolli, E.Islamaj, A.Brati, V.Bala, Xh.Zaganjori, G.Osmeni, A. Malaj, B. Muçi, B.Cani, A. Dollapaj, A.Kosova) ;

c) **1** prishje të vendimit (për subjektin A. Lazaj) ;

d) **2** pushim të shqyrtimit (për subjektin S. Tola dhe subjektin M. Xhaferllari).


Grafik 10: Vendimmarrja e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.



Organet ndihmëse të Komisionit në këtë proces janë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) për vlerësimin e pasurisë dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për vlerësimin e figurës. Vendimmarrja e Komisionit nuk është e kushtëzuar nga përfundimet e rezultateve të këtyre raporteve, pasi Kushtetuta i njeh KPK-së të drejtën e një hetimi të pavarur.


Sipas raporteve të ILDKPKI-së për **192** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar pa probleme me pasurinë **125** subjekte rivlerësimi dhe me probleme **67** prej tyre, ndërkohë që hetimi i kryer nga Komisioni ka dhënë rezultate të tjera: kanë rezultuar **87** subjekte pa probleme me pasurinë dhe **105** subjekte me probleme.

Grafik 11: Raporti i ILDKPKI-së dhe rivlerësimi i KPK-së



Nga raportet e DSIK-së për **160** subjekte rivlerësimi, kanë rezultuar të papërshtatshëm për vijimin e detyrës **33** subjekte rivlerësimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit rezultuan me probleme **21** prej tyre.

Grafik 12: Raporti i DSIK-së dhe kontrolli i figurës i KPK-së



KUALITETI